



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË GJAKOVËS PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkohet falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Ardian Gjini, Kryetar i Komunës

Adresa: Rr. Nëna Terezë 50000 Gjakovë, Gjakovë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Gjakovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Gjakovës (Komuna e Gjakovës), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjakovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Gjakovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komuna e Gjakovës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

1 Komuna si rezultat i pagesave nga thesari bazuar në vendime gjyqësore kishte paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 161,323€ në kategori ekonomike jo adekuate.

- Nga kategoria e investimeve kapitale janë realizuar pagesa në vlerë prej 11,280€ për paga jubilarë/paga përcjellëse për punëtorët si dhe pagesat në vlerë prej 8,167€ të cilat për nga natyra i takonin kategorisë së mallrave dhe shërbimeve; dhe
- Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve janë realizuar pagesa në vlerë prej 141,876€ për paga jubilarë/paga përcjellëse për punëtorët.

Duke qenë se çështja në fjalë është mjaft e përhapur në shumë organizata buxhetore dhe po përsëritet për vite me radhë, ajo do të trajtohet më hollësisht në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Gjakovës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Gjakovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Gjakovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Gjakovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për

atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Gjakovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpалosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Gjakovës në 2020 ishin në vlerë 2,919,388€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja, participimet etj. Përveç këtyre të hyrave komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat grumbullohen nga niveli qendror në vlerë prej 417,012€ (gjobat në trafik 379,612€ dhe të hyrat nga gjykata në vlerë prej 37,400€).

Çështja B1 - Vonesa në shqyrtimin e ankesave të tatimpaguesve

Gjetja Bazuar në nenin 31 pika 6 të Ligjit nr.06L/005 për Tatimin në pronën e paluajtshme – “Komuna merr vendim në lidhje me ankesën e dorëzuar brenda gjashtëdhjetë ditëve nga pranimi i ankesës. Komuna mund të zgjasë, deri në tridhjetë ditë kalendarike, afatin për shqyrtimin e ankesës së dorëzuar, me një vendim të arsyetuar”.

Nga gjithsej 203 ankesa të shqyrtuara nga komuna, në 11 raste ku tatimpaguesit kanë bërë ankesë lidhur me pasaktësinë e faturës së tatimit në pronë, shqyrtimi i tyre është bërë me vonesë, duke tejkaluar afatin ligjor për shqyrtim nga katër deri në pesë muaj.

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i gjendjes pandemike në vend me ç’rast Komuna ka operuar me staf të reduktuar.

Ndikimi Shqyrtimi i ankesave me vonesë nga autoritetet komunale dëmton marrëdhënien ndërmjet komunës dhe tatimpaguesve dhe paraqet shkelje ligjore.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet sigurojë se shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve bëhet brenda afateve ligjore. Po ashtu, Kryetari duhet të shtoj kontrollet që të siguroj se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për taksapaguesin.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 9,723,124€, prej tyre ishin shpenzuar 8,195,520€. Ato kanë të bëjnë me: ndërtimin e rrugëve lokale, ujësjellësve, kanalizimeve, parqeve nacionale, rregullimin e lumenjve etj. Kemi testuar 17 mostra për teste substanciale në vlerë 1,045,294€ si dhe tri mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A1 - Mos konfiskimi i sigurimit të tenderit

Gjetja Neni 57 pika 1 të LPP nr. 04/L-042 përcakton se: “Gjatë një aktiviteti të prokurimit që shpie drejt dhënies së një kontrate me vlerë të mesme ose të madhe, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga tenderuesit që të depozitojnë siguri (garantim) për tender. Siguria e tenderit që është depozituar nga tenderuesi do të konfiskohet, në rast se tenderuesit në fjalë i është dhënë kontrata përkatëse në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi pastaj refuzon ose dështon: (ii) që të përmbushë çfarëdo kushti tjetër që ishte specifikuar në dosjen e tenderit, para nënshkrimit të kontratës përkatëse”.

Në procedurën e prokurimit “Ndërtimi dhe sanimi i rrugëve me kubëza betoni”, komisioni i vlerësimit të ofertave dhe menaxheri i zyrës së prokurimit kanë vendosur të shpërblejnë me kontratë operatorin ekonomikë me ofertën me vlerë më të ulët prej 575,475€. Në kërkesën e komunës drejtuar OE për dorëzimin e dëshmime të kërkuara në pikën 6.4 (kërkesat e përshtatshmërisë) të dosjes së tenderit, respektivisht Vërtetimi nga ATK, Vërtetimi nga gjykata dhe Vërtetimit të tatimit në pronë, OE nuk i është përgjigjur dhe për këtë arsye është eliminuar. Komuna nuk ka ndërmarrë hapat e nevojshëm sipas pikës 8 të nenit 57 të LPP-së e që do duhej të njoftojë OE për konfiskimin e sigurisë së tenderit, në vlerë prej 20,000€.

Komuna ka vazhduar me procedurën e tenderimit duke mos konfiskuar sigurinë e tenderit për OE në fjalë ndërsa ka shpallur fitues OE e dytë me radhë në shumë prej 626,653€.

Kjo ka ndodhur sepse konzorciumi përbehej nga një OE vendorë dhe një tjetër nga Shqipëria. Nën presionin e situatës pandemike kishte vështirësi në komunikim dhe vështirësi financiare të OE për shkak të mos operimit të bizneseve në këtë kohë.

Ndikimi Mosveprimi për konfiskimin e sigurisë së tenderit i ka shkaktuar dëmtim buxhetit të komunës për vlerën e pa inkasuar të sigurimit të tenderit. Mos ndërmarrja e masave ligjore ofron mundësin e pjesëmarrësve jo serioz dhe të pa përgjegjshëm në tender, që rezulton edhe me kosto jo ekonomike.

Rekomandimi A1 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se do të aplikohet konfiskimi i sigurisë së tenderit në rastet kur operatorët ekonomik tërhiqen apo nuk përgjigjen për të plotësuar kërkesën mbi përshtatshmërinë. Konfiskimi i sigurisë së tenderit për ofertuesit e papërgjegjshëm zvogëlon mundësin e pjesëmarrjes së ofertuesve joserioz.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Parregullsi lidhur me çmimet për njësi në ofertën tenderuese

Gjetja Rregulla dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik, përkatësisht pika 4.2.c. përcakton se gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, AK do të ketë obligim “të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut”. Po ashtu, pika 11.1.b.percaktonë që zyrtari përgjegjës i prokurimit “siguron që mallrat, shërbimet dhe punët blihen në mënyrën më ekonomike, efikase dhe efektive”. Gjithashtu, pika 13.2, në parashikimin e vlerës së kontratës, AK duhet: “të merren parasysh çmimet e publikuara nga Zyra e Statistikave të Kosovës dhe/ose çmime tjera indikative zyrtare (të tilla si zyra tatimore, zyra e doganave, oda ekonomike, etj); dhe/ose, çmimet e tregut lokal; dhe/ose, çmimet e kontratave paraprake të nënshkruara nga autoriteti i njëjtë apo tjetër kontraktuese; dhe/ose, çmime ndërkombëtare të publikuara; dhe/ose, çmimet për njësi të publikuara në webfaqe të KRPP-se.

Komuna ka nënshkruar kontratën “Ndërtimi dhe sanimi i rrugëve me kubëza betoni” me dt.16.07.2020 në vlerë 626,653€ me afat dy vjeçar. Realizimi në total i kontratës në vitin 2020 është në vlerë 410,329€ apo 65%.

Ne kemi identifikuar se çmimi për pozicionet 1 deri 14 ekziston shpërputhje ndërmjet çmimeve të kontraktuara dhe atyre të paralogaritura në paramasë, në tabelën e mëposhtme kemi prezantuar çmimet abnormalisht më të larta për dy pozicione me diferencën më të madhe dhe për dy pozicione tjera me çmime abnormalisht më të ulëta me diferencën më të madhe (shih kolonën f në tabelë).

A	Përshkrimi	Oferta e fituesit			Vlera llogaritur nga paramasa		Audit diferenca	Realizimi i deritashem		
		Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH	Diferenca	sasia	vlera
Nr.			a	b	c=a * b	d	e = d * a	f = c - e	g	h = g * b
1	Inqizimi dhe verifikimi gjeodezik i konturave të trases së rrugës , trotuareve dhe shesheve . Në llogari duhet të kalkulohet edhe inqizimi i tersisem gjeodezik i konturave të trases së rrugës , trotuareve dhe shesheve cili duhet pas përfundimit të punimeve të dorzohet organit mbikqyres në menyre elektronike.	m ²	20,160	18.50	372,960	1.00	20,160	352,800	17,037	315,187
2	Gërmimi i gjërë i dheut (apo fraksioneve egzistuese) me makinë, ngarkimi dhe bartja deri në deponi. Llogaritet për m ² të pozicioni sipas përshkrimit.	m ²	9,072	3.40	30,845	1.50	13,608	17,237	6,927	23,551
4	Blerja, transporti dhe shtruarja e gurit të thyer - çakull (0 - 31.5 mm) d=15cm me ngjeshje të duhur në shtresa deri të arritja e modulit të ngjeshmerisë dhe dendësisë, sipas normave teknike. Llogaritet për m ² të pozicionit në gjendje të ngjeshur.	m ²	7,020	1.00	7,020	10.00	70,200	(63,180)	2,556	2,556
11	Blerja, transporti dhe shtruarja e kubëzave me trashësi t = 8.0 cm të atestuar dhe certifikuar sipas ISO standardeve. Në çmim është llogaritur edhe shtruarja e shtresës rrafshuese me fr. II. Forma e kubëzave caktohet nga investitori. Llogaritet në m ² të komplet pozicionit	m ²	44,200	1.00	44,200	6.30	278,460	(234,260)	9,560	9,560

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i kujdesit jo të duhur nga ana e komisionit vlerësues dhe menaxherit të prokurimit.

Ndikimi

Mangësitë e identifikuar lidhur me çmimet abnormalisht të larta apo/dhe të ulëta për pozicione në ofertën financiare tenderuese ndikon që buxheti të harxhohet në fillim të projektit dhe rritë rrezikun e dëmtimit buxhetor nëse kemi shkëputje të kontratës apo ndonjë pozicion i kontratës me çmim abnormalisht të ulët nuk do të realizohet. Kjo situatë reflekton negativisht në vlerësimin e saktë të kostos së projektit dhe në udhëheqjen e aktiviteteve të prokurimit në harmoni me parimet e konkurrencës, efikasitetit & efektivitetit.

Rekomandimi A2 Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në procesin vlerësimit të drejtë të çmimeve të njësive në kuadër të ofertave tenderuese sipas çmimeve të përllogaritura në paramasë, apo edhe manualeve me çmimet referente për njësi të publikuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, çmimeve të tregut dhe çmimeve tjera indikative zyrtare. Gjithashtu Kryetari të siguroj se do të realizohet secili pozicion i kontratës me përpikëri.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si psh: mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja A3 - Parregullsi në vlerësimin e ofertave

Gjetja

Sipas ligjit të prokurimit publik 04/L-042 neni 27 paragrafi 4 - Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Sipas RRUOPP-pika 41.11 “Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.”

- Në dosjen e tenderit “Sanimi dhe ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në qytetin e vjetër” janë kërkuar dëshmitë lidhur me mundësitë teknike dhe profesionale si: Lista e kontratave në 3 vitet e fundit duke saktësuar titullin e kontratës, shumën, datën dhe përfituesin, duke bashkangjitur certifikatat dhe kryerjen e punimeve. Gjithashtu në kuadër të pajisjeve është kërkuar në mes tjerash edhe dy mini eskavatorë.

Komisioni i vlerësimit në raportin e dt. 18.06.2020 ka vlerësuar se nga tre ofertues dy prej tyre kanë plotësuar kriteret e kërkuara. Nga ofertuesi me çmimin më të ulët prej 378,253€, me dt.11.06.2020 Komuna ka kërkuar informata shtesë brenda dy ditëve⁶ sipas nenit 72 të LPP – për referencat/kontratat e prezantuar nga OE, të qartësoj se çfarë lloj sanime, ndërtime, asfaltimeve apo kubzimeve të rrugëve kishin bërë. Gjithashtu, është njoftuar OE se i mungon dëshmia për të paktën dy mini eskavatorë ashtu si është kërkuar në FDT⁶. Pasi nuk ka pranuar përgjigje, AK ka eliminuar këtë ofertues, dhe me dt. 24.06.2020 ka nënshkruar kontratën me ofertuesin tjetër në vlerë prej 428,077€ apo me kosto më të lart prej 49,824€.

Ne kemi ekzaminuar dokumentacionin e kërkuar për tenderuesin e eliminuar dhe kemi konstatuar se informatat shtesë të kërkuara nga AK, veç ekzistonin në dosjen e tenderit të ofruar. Kërkesa për informata shtesë e bërë nga AK gjatë procesit të vlerësimit është në kundërshtim me kërkesat në dosjen e tenderit sepse komuna nuk kishte specifikuar punët për shtrimin me kubëza apo asfalt dhe kjo nuk specifikohet as në titullin e kontratës, derisa ekzistonin dëshmitë për posedimin e dy mini eskavatorë të bashkangjitura në dosjen e këtij ofertuesit.

Kjo gjendje është shkak i përcaktimit të paqartë të kriterëve bazë dhe vlerësimit jo të dejtë të ofertave financiare.

Sipas Ligjit të prokurimit publik 04/L-042 neni 59.4: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Komuna ka specifikuar në dosjen e tenderit ndër tjerash edhe kriterin se operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka në dispozicion ose kontratë mbi qiramarrjen një auto kran me peshë totale maksimum 2.5t”.

- Në procedurën e prokurimit “Organizimet e festave të fund vitit⁶, është përzgjedhur fitues i kontratës OE i cili nuk ishte i përgjegjshëm në mungesë të plotësisht të këtij kriteri (pjesa III - 2.4 - Kapaciteti teknik profesional). OE fitues kishte ofruar auto kranin me peshë prej 3.5t, pra me tonazh mbi atë të kërkuar, përderisa asnjëri nga OE të përfshirë në tenderim nuk kishin plotësuar kriterin e peshës së auto – kranit. Vlera e kësaj kontrate ishte 29,406€.

Kjo ka ndodhur nën presionin e kohës për shkak se ri tenderimi nuk kishte mundësi të zhvillohet duke pas parasysh zbulimin e qytetit për festat e fund vitit, rivlerësimi i këtyre ofertave është bërë me dt. 01.12.2020.

Ndikimi

Diskualifikimi i padrejtë i ofertuesit nga komisioni vlerësues ka për pasojë dëmtimin e buxhetit komunal për shkak se kontrata është nënshkruar me kosto më të lartë. Ndërsa tek rasti tjetër dhënia e kontratës operatorit ekonomik të papërgjegjshëm me çmimin më të lartë ndikon potencialisht në mosrealizimin efikas të objektivit dhe dëmton qëllimin për të cilin është vendosur kriteri i auto kranit me peshë prej 2.5t. ,

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të siguroj se kontrollet janë funksionale në menaxhimin e procesit të vlerësimit të tenderëve, në mënyrë që ky proces të jetë i drejtë dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe të mos eliminohen operatorët ekonomik të përgjegjshëm me ofertën me të leverdishme ekonomike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Shpenzime shtesë si rezultat i vendimeve gjyqësore/përmbartimore

Gjetja Neni 40, për pagimin e vendimeve të prera gjyqësore, paragrafi 3 përcakton se pas pranimit të vendimit të plotfuqishëm ose urdhrit të formës së prerë, ministria është e autorizuar dhe ka përgjegjësinë që menjëherë të marr çfarëdo masa të nevojshme për pagimin e vendimit ose urdhrit nga ndarjet buxhetore në dispozicion.

Thesari ka realizuar nga buxheti i komunës pagesa në vlerë 215,818€ prej tyre 88,284€ ishin kosto shtesë për shpenzimet gjyqësore, përmbarimore dhe të interesit⁵.

Kjo ka ndodh si rezultat i mos pagesës me kohë të obligimeve financiare dhe kërkesave për paga jubilarë apo paga përcjellëse, dhe pagesave ndaj furnitorëve, përmes procedurave gjyqësore/përmbarimore, në mungesë të buxhetit.

Ndikimi

Pagesat e realizuara përmes vendimeve gjyqësore dhe pagesave direkte nga thesari, vështirësojnë realizimin e buxhetit sipas planifikimeve respektivisht implementimin e projekteve, po ashtu krijojnë kosto shtesë në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe interesit.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë planifikimin e drejtë të buxhetit duke forcuar disiplinën financiare që procesi i realizimit të pagesave të bëhet brenda planifikimeve buxhetore dhe afateve kohore të përcaktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 70,363,158€, pasurive jokapitale është 1,435,307€, si dhe e stoqeve 174,463€. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 3,999,596€, si dhe 70 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B2 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja

Neni 6 i rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare nr.02/2013 përcakton që: “Çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Sipas nenit 22 pika 1 - zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtvizore. Po ashtu, sipas nenit 18 pika 3 - Organizatat buxhetore duhet të kontrollojnë së paku njëherë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë jo financiare dhe një aktivitet tjetër që i paraprinë inventarizimit është se komuna duhet nxjerr udhëzim të brendshëm sipas nenit 19 pika 5. Pasuritë duhet të vlerësohen duke marrë parasysh zhvlerësimin që është grumbulluar nga momenti i blerjes së pasurisë. Gjetjet janë si në vijim:

- Kryetari ka emëruar komisionin e inventarizimit me dt.16.11.2020 i cili nuk ka arritur të kryej inventarizimin e pasurisë jofinanciare për vitin 2020.

Kjo gjendje pjesërisht është rezultat i mos funksionimit të E-pasurisë, mungesës së udhëzuesve të brendshëm të pasurisë dhe mos kompetencës së komisionit të inventarizimit⁷.

- Regjistri i pasurisë kapitale është përmirësuar dukshëm megjithatë ne kemi gjetur se 12 mostra, pasuri kapitale (automjete të cilat i takojnë periudhave të hershme nga viti 2001 e deri në vitin 2007) figurojnë në libra me vlerën e tyre fillestare në total prej 34,357€, edhe pse vlera neto në libra do duhej të ishte zero. Kjo gjendje është rezultat i vendosjes së të dhënave fillestare në SIMFK në mënyrë të gabuar pa iu përcaktuar norma e zhvlerësimit dhe mos rishikimit të vazhdueshëm të tyre nga procesi i brendshëm i kontrollit.

Kjo gjendje është rezultat i vendosjes së të dhënave fillestare në SIMFK në mënyrë të gabuar pa iu përcaktuar norma e zhvlerësimit dhe mos rishikimit të vazhdueshëm të tyre nga procesi i brendshëm i kontrollit.

- Komuna nuk ka mundur të ofroj regjistrin e plotë dhe të saktë për pasuritë jokapitale për arsye të defektit në sistemin e-pasuria dhe pamundësisë për gjenerimin e tij. Komuna ka bërë përpjekje dhe ka kërkuar nga mirëmbajtësit e sistemit për të rregulluar sistemin por pa ndonjë rezultat.
- Vlera e pasurisë jokapitale nën 1,000€ e prezantuar në PVF ishte 1,435,306€ e cila përmbante vlerën neto të vitit të kaluar 1,266,634€ dhe blerjet e vitit 2020 prej 168,673€ të cilat nuk ishin evidentuara në regjistrin përkatës, duke mos bërë kalkulimin e zhvlerësimit. Në mungesë të regjistrit të plotë dhe saktë të kësaj pasuri auditori nuk ofron siguri se kjo llogari është prezantuar drejt në PFV.

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mos mirëmbajtjes së sistemit nga ana e kompanisë e cila ka një kontratë të centralizuar me MAP(*).

Ndikimi

Mungesa e inventarizimit dhe mos zhvlerësimi i asetëve ndikon që prezantimi i pasurisë në regjistrat e Komunës dhe pasqyrat financiare vjetore të mos jetë i saktë dhe i plotë dhe rrezikon humbjen apo përvetësimin e pasurisë në mënyrë të paligjshme.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të siguroj përzgjedhjen e anëtarëve kompetent në komisionin e inventarizimit dhe të nxjerr një udhëzues të brendshëm për inventarizimin e pasurisë duke sqaruar mandatin e plotë dhe të saktë të tij sipas rregullores për menaxhimin e pasurisë jofinanciare. Gjithashtu të ndërmerr masa në korigjimin e vlerës neto në libra të 12 asetëve dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike e cila ka kontratë direkte me mirëmbajtësit e softuerit të e-pasurisë të mundësoj sanimin e defekteve në sistem në mënyrë që

regjistri i pasurisë jokapitale të mund të azhurnohet dhe gjenerohet me kohë, para hartimit të PVF për vitin 2021.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.5 Të arkëtueshmet

Komuna në PVF e vitit 2020 ka shpалosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 10,312,829€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë, qiraja e dyqaneve, qiraja e tokave, qiraja e tregjeve dhe taksa në firmë.

Çështja B3 - Rritje e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Bazuar në neni 27 të Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe nenit 16 të Rregullores për Taksa Tarifa, Ngarkesa dhe Shërbimet Komunale, ku përcaktojnë mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara duke përdorur masat e mbledhjes së detyrueshme. Dhe neneve 1,3 dhe 4 të Ligjit nr.06/L092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe në nenin 5 të kontratës për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale ku specifikohet se deri me datën 05 të secilit muaj duhet të kryhet pagesa nga ana e shfrytëzuesit të pronës.

Në raport me vitin 2019 kemi një rritje llogarive të arkëtueshme për 1,043,464€, veçanërisht të ndërmarrjet shoqërore (tatimi në pronë) dhe taksa në firmë (bastoret). Komuna përveç dërgimit të 48 letër kujtesave, nuk ka bërë përpjekje tjera (ngritje të padis apo procesit përmbarimore) për inkasimin e mjeteve të pa arkëtuara qoftë nga tatimi në pronë, qiratë nga toka, dyqanet, tregjet apo taksat në firmë.

Kjo ka ndodhur si shkak i situatës pandemike dhe kujdesit jo të duhur.

Ndikimi Mos arkëtimi i të hyrave të ngarkuara ndikon në pamundësinë e Komunës për t'i përmbushur planet e shpenzimeve dhe po ashtu mund të rezultojë në vështirësi të mëtutjeshme në arkëtimin dhe vjetërsimin e të arkëtueshmëve deri në shndërrimin e tyre në borxh të keq.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e të arkëtueshmëve, duke përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbaruesve, për të siguruar arkëtimin e plotë të llogarive të arkëtueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.6 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2020, ishte 612,410€, kjo vlerë përbëhet kryesisht nga shpenzimet në investime kapitale, mallra dhe shërbime, shërbime komunale si dhe subvencione dhe transfere. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2021.

Çështja B4 - Detyrime të vjetruara dhe mungesa e përpjekjeve për shlyerjen e tyre

Gjetja Me nenin 39 të LMFPP, kërkohet që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallrat dhe shërbimet e realizuara të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Obligimet në krahasim me vitin paraprak kanë shënuar rënie, megjithatë në regjistrin e obligimeve të papaguara ende ekzistojnë obligime të vjetra: pesë fatura nga viti 2013 (mirëmbajtje e automjetit), një faturë e vitit 2018 (furnizim me CD) dhe 11 fatura të vitit 2019 (material për zyre). Këto obligime në total janë në vlerë prej 5,769€ ndonëse me vlerë të vogël por kjo tregon brishtësinë e sistemit të obligimeve të papaguara.

Shkak i mos pagesës me kohë të detyrimeve është planifikim jo i mirë i alokimit/zotimit të mjeteve dhe inicimi i proceduarve të shpenzimeve pa mjete në dispozicion. Komuna e arsyeton këtë situatë edhe me mungesën e dokumentacionit mbështetës, në disa raste ata deklarojnë se nuk kanë raporte të pranimit për këto detyrime të vjetra, dhe kjo pamundëson pagesën.

Ndikimi Detyrimet e bartura rrisin rrezikun në realizimin e projekteve dhe në arritjen objektivave të komunës. Si rezultat i nevojës për t'i paguar (obligimet) zotimet e viteve paraprake, njëherit kjo ndikon edhe në kosto shtese në rast të padive nga furnitorët.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të shtoj kujdesin për një planifikim më të mirë të alokimit dhe zotimit të mjeteve si dhe inicimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të detyrimeve ndaj OE-ve. Gjithashtu, Kryetari duhet siguroj që të kryhen të gjitha detyrimet e viteve paraprake.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.7 Detyrimet kontingjente

Pasqyra e detyrimeve kontingjente në fund të vitit 2020 ishte 454,636€. Në këtë vlerë përfshihen vetëm vendimet përmbareme lidhur me kontestet e ndryshme si: Kompensime për profite të humbura, kompensim prone, vërtetim pronësie etj.

Çështja A4 - Llogari jo e plotë e detyrimeve kontingjente në pasqyra financiare

Gjetja Detyrimet kontingjente janë obligimi i mundshëm që rrjedh nga ngjarjet e të kaluarës dhe ekzistimi i të cilit do të vërtetohej vetëm nga ndodhja ose mos ndodhja e një ose më tepër ngjarjeve të pasigurta në të ardhmen që nuk janë tërësisht përbrenda kontrollit të komunës.

Komuna nuk posedon ende një regjistër të plotë të të gjitha pretendimeve të palëve të jashtme ndaj komunës. Në tetë raste në vlerë prej 158,850€ të cilat ishin ende në procese gjyqësore nuk janë përfshirë në regjistrin e detyrimeve kontingjente.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos krijimit të një regjistri të përgjithshëm i cili do duhej të azhurnohej dhe mirëmbahej ndër vite lidhur me detyrimet kontingjente nga zyra ligjore në Komunë.

Ndikimi Mos prezantimi i plotë dhe i saktë i detyrimeve kontingjente në PVF ndikon në keqinformimin e përdoruesve të pasqyrave financiare mbi bazën e të cilave merren vendime potencialisht të gabuara.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të siguroj një sistem të mirëfilltë të kontrollit në mënyrë që të krijohet dhe mirëmbahet regjistri i përgjithshëm i detyrimeve kontingjente dhe llogaria e tyre të prezantohet e plotë dhe e saktë në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.8 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Komuna ka të themeluar njësinë e auditimit të brendshëm (NJAB) e cila operon me një anëtar, po ashtu ka themeluar edhe komitetin e auditimit i cili përbëhet nga tre anëtarë. NJAB ka përgatitur planin vjetor dhe strategjik të auditimit të brendshëm, në vitin 2020 NJAB ka kryer tre auditime sipas planit vjetor të cilat kanë të bëjnë me drejtoritë: Gjeodezi, kadastër dhe pronë, buxhet dhe financa dhe sektorin e prokurimit. NJAB ka dhënë gjithsej nëntë rekomandime pesë prej të cilave sipas vlerësimit të tij janë zbatuar, një është në proces dhe tri janë ende të pazbatuara. Raportet e Auditimit të Brendshëm kanë mbuluar vitin aktual 45% ndërsa vitin e kaluar prej 55%.

Çështja C2 - Dobësi në fushën e auditimit të brendshëm

Gjetja Në fushën e auditimit të brendshëm shpalosim dobësitë në vijim:

UA 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik sipas nenit 6, “Komiteti i Auditimit emërohet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe përbëhet nga tre ose pesë anëtarë.

- Komuna ka emëruar komitetin e auditimit me 30 shtator të vitit 2020 çfarë nënkupton se nëntë muajt e vitit nuk është monitoruar puna e NJAB.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos emërimit me kohë të komitetit të auditimit.

Rregullorja (QRK) nr. 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik neni 5, pika 1 kërkon që “udhëheqësi i subjektit të sektorit publik themelon Njësinë e pavarur të auditimit të brendshëm sipas këtyre kriterëve: 1.1 Subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë milionë euro të ketë së paku tre auditorë të brendshëm”.

- NJAB kishte vetëm një auditor dhe nuk ka arritur ti mbuloj të gjitha fushat me rrezik duke filluar me plotësinë e regjistrave të pasurisë, menaxhimit e kontratave të pronave të dhëna në shfrytëzim, llogaritë e arkëtueshme dhe pagueshme, detyrimet kontingente etj.

Kjo ka ndodhur për shkak të burimeve të pamjaftueshme në auditimin e brendshëm në komunë.

Ndikimi Mungesa e komitetit të auditimit për pjesën më të madhe të vitit dhe burimet e pamjaftueshme të NJAB ndikon negativisht në përmirësimin e sistemeve të kontrollit në komunë dhe në arritjen e objektivave të saj.

Rekomandimi C2 Kryetari duhet të rishikoj performancën e NJAB dhe sipas nevojës dhe mundësisë financiare dhe buxhetore të ndërmerr veprime për shtimin e kapaciteteve njerëzore brenda NJAB.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁹	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	27,252,717.00	29,314,297.71	27,339,931.19	25,626,846.22	23,109,387.01
Grante Qeveritare - Buxheti	23,530,350.00	23,606,568.52	23,077,881.81	20,769,698.99	19,746,629.41
Financimi përmes huamarrjes	0.00	259,610.00	228,258.70	48,173.41	28,745.50
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	1,239,730.10	1,013,578.31	1,533,053.15	1,073,613.42
Të hyrat vetanake	3,722,367.00	3,722,367.00	2,602,542.73	2,978,143.82	2,009,168.56
Donacionet vendore	0.00	67,120.56	13,995.00	2,762.00	55,582.90
Donacionet e jashtme	0.00	418,901.53	403,674.64	295,014.85	195,647.22

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 2,061,581€. Kjo rritje është rezultat i pranimit të donacioneve, të hyrave të bartura nga viti paraprak, huamarrja dhe rimëkëmbja. Në vitin 2020 komuna ka shpenzuar 93% të buxhetit final në 2020 ose 27,339,931€, me një ulje prej 3% në krahasim me vitin 2019. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	27,252,717.00	29,314,297.71	27,339,931.19	25,626,846.22	23,109,387.01
Pagat dhe mëditjet	13,817,893.00	14,263,962.78	14,242,132.73	13,599,827.88	13,252,490.92
Mallrat dhe shërbimet	3,004,103.00	3,968,730.47	3,687,338.49	2,834,452.75	2,234,274.89
Komunalitë	586,800.00	602,664.35	532,669.54	579,693.17	549,083.33
Subvencionet dhe transferet	510,500.00	755,815.67	682,270.70	482,643.78	459,572.71
Investimet Kapitale	7,097,485.00	9,723,124.44	8,195,519.73	8,130,228.64	6,613,965.16
Rezervat	2,235,936.00	0.00	0.00	0.00	0.00

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:


- Rritja e buxhetit final për paga dhe mëditje për 446,070€, mallra dhe shërbime me 964,628€ si dhe e shpenzimeve komunale për 15,864€ është një reflektim i pranimeve nga donacionet, të hyrave vetanake dhe të bartura nga viti i kaluar, rritja buxhetore nga huamarrja dhe linja vertikale si dhe rimëkëmbja ekonomike.
- Buxheti final për mallra, shërbime dhe komunalitet në vitin 2020 ishte 4,571,395€, prej tyre ishin shpenzuar 4,220,008€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzime kontraktuese tjera, shërbime komunale, mobile dhe pajisje tjera, mirëmbajtje dhe riparime etj. Komuna deri në korrik të 2020, kishte angazhuar 41 punonjës përmes MSHV-ve, për të cilët nuk kishte zhvilluar ndonjë procedurë formale të rekrutimit. Angazhimi i punonjësve me MSHV apo detyra specifike në shumicën e rasteve ishte bërë për të mbuluar pozitat të rregullta të punës (si, bashkëpunëtor profesional, asistentë, zyrtar arkivues, inspektor etje.) që duhet të planifikohen, rekrutohen sipas rregullave të konkursit dhe paguhet nga kategoria e pagave. Kjo gjendje ka ndodhur si rezultat i vështirësisë në rekrutim për pozita të rregullta dhe kujdesit jo të duhur në zbatimin e prokurimit për shërbimin e sigurimit dhe pastrimit.
- Buxheti final për investimet kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,625,639€, përkundër kësaj rritje buxheti ishte shpenzuar në masën prej 84%. Programi i investimeve publike (PIP) përfshin 33 projekte në vazhdim nga viti i kaluar (2019) dhe 132 projekte të reja për vitin aktual (2020). Po ashtu, Komuna kishte edhe 66 projekte të buxhetuara për të cilat nuk kishte shpenzim në vitin 2020 prej të cilave 46 janë rezultat i tepicës buxhetore pasi projektet janë përfunduar dhe 20 tjera nuk kanë filluar fare për arsye të ndryshme si: vonesa në procesin e prokurimit, ankesave në OSHP, mosrealizimit të të hyrave për arsye të pandemisë, kthimit të pagesave nga thesari etj.
- Komuna në vitin 2020 posedon detyrime kontraktuale sipas evidencave të saja në vlerë prej 7,208,334€. Detyrimet kontraktuale kanë të bëjnë kryesisht me kontratat dyvjeçare për ndërtimin dhe asfaltimin e rrugëve, ndërtimin e kanaleve të ujitjes në zonat rurale, ndërtimin e qendrës kryesore të mjekësisë familjare, renovime të ndryshme të objekteve që lidhen me drejtorin e kulturës, administratës dhe arsimit.

Për shkak të situatës pandemike me Covid-19 komuna e Gjakovës kishte shpenzuar buxhet të ndarë për këtë qëllim në vlerë totale prej 1,188,659€, prej të cilave 889,674€ ishin për shtesa në paga dhe mallra e shërbime për menaxhimin e emergjencës nga COVID-19 si dhe 298,985€ për mallra dhe shërbime nga buxheti për rimëkëmbje ekonomike.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Gjakovës në 2020 ishin në vlerë 2,919,388€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja, participimet etj. Përveç këtyre të hyrave komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat grumbullohen nga niveli qendror në vlerë prej 417,012€ (gjobat në trafik 379,612€ dhe të hyrat nga gjykata në vlerë prej 37,400€).

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	3,722,367.00	3,722,367.00	2,919,387.75	3,328,410.01	3,121,668.40
Të hyrat tatimore	2,084,585.00	2,084,585.00	1,411,815.27	1,686,809.98	1,456,041.40
Të hyrat jo tatimore	1,637,782.00	1,637,782.00	1,507,572.48	1,641,600.03	1,665,627.00

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2019 të Komunës së Gjakovës ka rezultuar në 14 rekomandime. Komuna ka përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Komuna ka përcjellë edhe një raport për progresin e zbatimit të rekomandimeve. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, pesë rekomandime janë zbatuar, dy janë në proces, katër nuk janë adresuar dhe tri janë të mbyllura, siç është paraqitur në Grafikon 4, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet ndërmarra	Statusi
1.	Keqklasifikimet - Investimet dhe Vendimet Gjyqesore	Kryetari duhet të siguroj që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestnimi i mjeteve sipas kërkesave ligjore dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë strikte sipas kategorive ekonomike adekuate. Veçanërisht një planifikim i drejtë i buxhetit dhe shpenzimeve për pagat përcjellëse për punëtorët.	Kjo çështje do të trajtohet në Raportin vjetor të auditimit RVA.	Nuk është i aplikueshëm më
2.	Të hyrat	Kryetari i komunës duhet të dizajnoj sistem të avancuar të kontrollit lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale duke vlerësuar të gjitha kontratat, duke ndërmarr masa në arkëtimin e të hyrave të pa inkasuara. Në dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, Kryetari duhet shfrytëzuar procedurat sipas kërkesave të ligjit 06/L-092 për shfrytëzimin dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.	Janë ndërmarr veprimet e nevojshme kanë hapur ankand për dhënien e pronave në shfrytëzim dhe janë në proces.	I zbatuar
3.	Të hyrat	Kryetari duhet sigurojë se shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve bëhet brenda afateve ligjore. Po ashtu, Kryetari duhet të shtoj kontrollet që të siguroj se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për taksapaguesin.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se kontrolli i vijueshmërisë në punë është funksional dhe secila njësi përkatëse përcjell vijueshmërinë në punë të stafit dhe puna jashtë orarit të mbulohet me dëshmi që arsyeton pagesën.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme dhe nuk janë detektuar raste në vitin 2020.	I zbatuar
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të ndërmerr masa në rekrutimin e pozitave të përhershme dhe tenderimin me kohë për shërbimet e mirëmbajtjes në QKMF dhe QPS. Angazhimet me MSHV të aplikohen vetëm për punë specifike dhe kushte të paparashikuara, gjithmonë duke i zbatuar kërkesat	Me hyrjen në fuqi të ligjit për zyrtarët publik ka ndryshuar kriteri i gjetjes.	Nuk është i aplikueshëm më

		ligjore.		
6.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që hyrja në obligime kontraktuale të mos bëhet pa u siguruar mjetet e nevojshme financiare për zbatimin e drejtë të kontratës.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Kryetari të sigurojë se projektet kapitale planifikohen drejtë në aspektin buxhetor dhe kohorë dhe hyrja në obligime kontraktuale të bëhet vetëm pasi të jenë siguruar mjetet e nevojshme financiare për implementimin e projekteve kapitale.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme	I zbatuar
8.	Çështjet përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë planifikimin e drejtë të buxhetit duke forcuar disiplinën financiare që procesi i realizimit të pagesave të bëhet brenda planifikimeve buxhetore dhe afateve kohore të përcaktuara.	Janë ndërmarrë veprime të pjesërishme ndërsa rezultatet janë dukshëm më të ulëta se vitin e kaluar	Pjesërisht i zbatuar
9.	Çështjet përbashkëta	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që procesi i ekzekutimit të pagesave të bëhet në harmoni me procedurat e përcaktuara me LMFPP dhe rregullat financiare për shpenzimin e parave publike.	Nuk janë detektuar raste të reja.	I zbatuar
10.	Çështjet përbashkëta	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në procesin e planifikimit të projekteve kapitale dhe sigurimit të kohëzgjatjes së sigurisë së ekzekutimit në përputhshmëri me kriteret kontraktuale dhe rregullat e prokurimit publik përfshirë edhe procesin e realizimit të subvencioneve.	Nuk janë detektuar raste të reja. Por rasti i viti të kaluar nuk është korriguar.	Nuk është i aplikueshëm më
11.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj trajnime shtesë për personat përgjegjës në regjistrimin e pasurisë, të ndërmerr masa në mirëmbajtjen e softuerit e pasuria në mënyrë që zhvlerësimi të ndodhë me kohë dhe të nxjerr një udhëzues të brendshëm për inventarizimin e pasurisë duke sqaruar mandatin e plotë dhe të saktë të tij sipas rregullores për menaxhimin e pasurisë jofinanciare.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimin

12.	Llogaritë arkëtueshme	Kryetari duhet të analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e borxheve, duke përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbaruesve, për të siguruar arkëtimin e plotë të llogarive të arkëtueshme. Po ashtu, të shqyrtoj mundësin që të jap me qira për një periudhë më të shkurtër kohore pronat komunale për shkak të ndryshimeve të mundshme në tarifatatimore dhe se për të gjithë shfrytëzuesit e pronave komunale të ketë kontrata valide.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimi
13.	Obligimet papaguara	Kryetari duhet të siguroj një planifikim më të mirë të alokimit dhe zotimit të mjeteve si dhe inicimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të detyrimeve ndaj OE-ve. Gjithashtu Kryetari duhet siguroj që të kryhen të gjitha detyrimet e viteve paraprake.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimi
14.	Auditimi Brendshëm	Kryetari duhet të zëvendësoj kryesuesin e komitetit të auditimit sipas kërkesave të udhëzimit administrativë përkatës dhe të funksionalizoj komitetin e auditimit. Gjithashtu plotësimi i auditimit të brendshëm me staf shtesë është i nevojshëm për të mbuluar fushat me rrezik.	Janë ndërmarrë veprime por jo të mjaftueshme	Pjesërisht i zbatuar

Nr	Fusha Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Të hyrat	Kryetari duhet sigurojë se shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve bëhet brenda afateve ligjore. Po ashtu, Kryetari duhet të shtoj kontrollet që të siguroj se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për taksapaguesin.
2.	Investimet kapitale	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se do të aplikohet konfiskimi i sigurisë së tenderit në rastet kur operatorët ekonomik tërhiqen apo nuk përgjigjen për të plotësuar kërkesën mbi përshtatshmërinë. Konfiskimi i sigurisë së tenderit për ofertuesit e papërgjegjshëm zvogëlon mundësin e pjesëmarrjes së ofertuesve joserioz.
3.	Investimet kapitale	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në procesin vlerësimit të drejtë të çmimeve të njëjësive në kuadër të ofertave tenderuese sipas çmimeve të përlogaritura në paramasë, apo edhe manualeve me çmimet referente për njësi të publikuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, çmimeve të tregut dhe çmimeve tjera indikative zyrtare. Gjithashtu Kryetari të siguroj se do të realizohet secili pozicion i kontratës me përpikëri.

4.	Çështjet përbashkëta	e	Kryetari duhet të siguroj se kontrollet janë funksionale në menaxhimin e procesit të vlerësimit të tenderëve, në mënyrë që ky proces të jetë i drejtë dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe të mos eliminohen operatorët ekonomik të përgjegjshëm me ofertën me të leverdishme ekonomike.
5.	Çështjet përbashkëta	e	Kryetari duhet të sigurojë planifikimin e drejtë të buxhetit duke forcuar disiplinën financiare që procesi i realizimit të pagesave të bëhet brenda planifikimeve buxhetore dhe afateve kohore të përcaktuara.
6.	Pasuritë		Kryetari duhet të siguroj përzgjedhjen e anëtarëve kompetent në komisionin e inventarizimit dhe të nxjerr një udhëzues të brendshëm për inventarizimin e pasurisë duke sqaruar mandatin e plotë dhe të saktë të tij sipas rregullores për menaxhimin e pasurisë jofinanciare. Gjithashtu të ndërmerr masa në korrigjimin e vlerës neto në libra të 12 aseteve dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike e cila ka kontratë direkte me mirëmbajtësit e softuerit të e-pasurisë të mundësoj sanimin e defekteve në sistem në mënyrë që regjistri i pasurisë jokapitale të mund të azhurnohet dhe gjenerohet me kohë, para hartimit të PVF për vitin 2021.
7.	Llogaritë arkëtueshme	e	Kryetari duhet të analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e të arkëtueshmëve, duke përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbaruesve, për të siguruar arkëtimin e plotë të llogarive të arkëtueshme.
8.	Obligimet papaguara	e	Kryetari duhet të shtoj kujdesin për një planifikim më të mirë të alokimit dhe zotimit të mjeteve si dhe inicimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të detyrimeve ndaj OE-ve. Gjithashtu, Kryetari duhet siguroj që të kryhen të gjitha detyrimet e viteve paraprake.
9.	Detyrimet Kontingjente		Kryetari duhet të siguroj një sistem të mirëfilltë të kontrollit në mënyrë që të krijohet dhe mirëmbahet regjistri i përgjithshëm i detyrimeve kontingjente dhe llogaria e tyre të prezantohet e plotë dhe e saktë në PVF.
10.	Auditimi Brendshëm	i	Kryetari duhet të rishikoj performancën e NJAB dhe sipas nevojës dhe mundësisë financiare dhe buxhetore të ndërmerr veprime për shtimin e kapaciteteve njerëzore brenda NJAB.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Emine Fazliu, Ndhmëse e Auditorit të Përgjithshëm




Luljeta Morina, Udhëheqëse e Auditimit



Muhamet Balaj, Udhëheqës i ekipit



Ejup Simnica, Anëtar i ekipit



Mexhit Ferati, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Leter konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Gjakovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.



z. Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

Data: 07.07.2021



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹⁰ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.¹¹ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Auditori këto të dhëna i bazon në raportin e siguruar nga komuna. Në kuadër të kësaj shume përfshihen mjetet e tërhequra me vendime gjyqësore prej 215,818€ prej të cilave shpenzimet e gjyqësorit dhe interesit janë 88,283€. Gjithashtu Thesari ka ekzekutuar pagesat direkte prej 53,888€ sipas nenit 39.2 të LMFP. Në kuadër të regjistrimit janë testuar gjithsej 7 mostra me vlerë 95,050€ të cilat vërtetojnë saktësinë e regjistrimit të ofruar nga ana e Komunës.
- ⁶ Dita kur është kërkuar sqarim apo informata shtesë është ditë e Premte. FDT - Formulari i Dosjes së Tenderit. Dekorim i qytetit për festat e fundvitit
- ⁷ Mosfunksionimi i e-pasurisë ka ndikuar që Komisioni mos ta ketë regjistrin e aseteve jokapitale për të filluar me procesin e inventarizimit.
- ⁸ Pasqyra e detyrimeve kontingjente në fund të vitit 2020, ishte 454,636€ të cilat kanë të bëjnë kryesisht me pretendimet përmbartimore të palëve qoftë persona fizik apo juridik.
- ⁹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ¹⁰ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹¹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.